



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 3610 prot.

Tiranë, më 05.07.2018

Lënda: Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë 2018

UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR

Prof. Adem Bekteshi
Rektor

I nderuar zoti Rektor,

Nëpërmjet kësaj letre, kam kënaqësinë e veçantë t'Ju informoj se Banka e Shqipërisë ka shpallur konkursin e përvitshëm "**Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë 2018**".

Në këtë konkurs janë të ftuar të konkurrojnë të gjithë studentët e interesuar, të diplomuar gjatë vitit 2018, me temat e tyre të diplomës, të cilat fokusohen në çështje të lidhura me veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë. Si çdo vit përzgjedhja e 3 temave fituese do të bëhet nga një komisioni i posaçëm shkencor i ngritur pranë Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim.

Tashmë dhënia e këtij çmimi përbën një traditë të përvitshme të Bankës së Shqipërisë, e cila synon të nxisë studentët që të ndërmarrin studime të serioze në fushën e bankingut qendror dhe të ekonomisë në përgjithësi.

Në këtë kuadër, do ta vlerësojm shumë ndihmën Tuaj për të informuar pedagogët dhe studentët duke mundësuar ekspozimin e posterave bashkëlidhur në mjediset e universitetit Tuaj.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

Sinqerisht,

GUVERNATOR

Gent Sejko

